



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0433**

Organi Shqyrtues i Prokurimit përmes Panelit Shqyrtues në përbërje të Vjosa Gradinaj Mexhuani – Kryetare, Vedat Poterqoi – Anëtar, Agon Ramadani - Anëtar duke vendosur mbi ankesën e operatorit ekonomik “Solvit” Sh.P.K. kundër Njoftimit mbi Vendimin të datës 09.06.2023 të Autoritetit Kontraktues - Komuna e Prishtinës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me tabela të mençura (smart) për institucionet arsimore në Komunë të Prishtinës” me numër të prokurimit 616-23-3949-1-1-1, në bazë të nenit 105 lidhur me nenin 106 dhe nenin 117 të LPP, pas shqyrtimit në seancën pa prezencën e palëve me datë 25.09.2023 merr këtë:

## Vendim

- I.** Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Solvit” Sh.P.K. me nr. 2023/0433 e datës 26.06.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin të datës 09.06.2023 të Autoritetit Kontraktues - Komuna e Prishtinës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me tabela të mençura (smart) për institucionet arsimore në Komunë të Prishtinës” me numër të prokurimit 616-23-3949-1-1-1.
- II.** Anullohet Njoftimi mbi Vendimin i Autoritetit Kontraktues i datës 09.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit ndërsa aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.
- III.** Detyrohet Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës për zbatimin e këtij vendimi si dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të vendimit të dërgoj në OSHP njoftimin lidhur me veprimet që ndërmerren për zbatimin e tij, të gjitha këto nën paralajmërimin se në rast të moszbatimit të këtij vendimi, OSHP do të ndërmerr masat kundër Autoritetit Kontraktues në përputhje me nenin 131 të LPP.
- IV.** Lejohet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar ashtu që obligohet operatori ekonomik ankues që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të këtij vendimi të parashtoj kërkesë për kthimin e tarifës së ankesës në përputhje me nenin 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, nën paralajmërimin që nëse nuk parashtrohet kërkesa brenda afatit, do të bëhet konfiskimi i depozitës dhe të gjitha mjetet e deponuara do të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 25.04.2023 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me tabela të mençura (smart) për institucionet arsimore në Komunë të Prishtinës” me numër të prokurimit 616-23-3949-1-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës për furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 400,000.00 €. Kriteri i dhënies ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të lirë.

Me datë 09.06.2023 Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka rekomanduar për dhënie të kontratës grupin e operatorëve ekonomik “Blendi” O.P. & “Tech Vision” Sh.P.K.

Me datë 13.06.2023 operatori ekonomik ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 të Autoritetit Kontraktues. Rrjedhimisht me datë 14.06.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues.

Operatori ekonomik ankues me datë 26.06.2023 ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 433/23.

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nënparagrafin 75 të LPP.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë parashtruar përmes ankesës si në vijim:

- **Pretendimi i parë (I)** - *“Autoriteti Kontraktues në dosje të tenderit te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale kanë përcaktuar kërkesën për qarkullim 600,000.00 Euro në tri vitet e fundit ndërsa si dëshmi është kërkuar një listë e kontratave të realizuara duke plotësuar Aneksin 6 ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës t’i bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të furnizimeve. Prandaj vetë autoriteti ka kërkuar detyrimisht të plotësohet aneksi 6 i dosjes së tenderit. Tenderuesi i rekomanduar për kontratë konkretisht*

*lideri i konzorciumit NTG Blendi është munduar që të plotësoj listën e kontratave dhe referencat duke plotësuar aneksin 6 mirëpo nuk e përmbushë kërkesën prej 600,000.00 euro në tri vitet e fundit. Përkundër se mungon totali, ne i mbledhim 192,080.00 dhe 32,935.00 që bëjnë 225,015.00 mirëpo prap nuk arrihet shuma prej 600,000.00 vetëm me operatorin NTG Blendi. Anëtarë i dytë i konzorciumit Techvision nuk ka dorëzuar fare aneksin 6 por ka dorëzuar vetëmnjë listë paushalle. Çdo aneks i kërkuar nga autoriteti kontraktues është formular i domosdoshëm për t'u kualifikuar si ofertë administrativisht e përgjegjshme”.*

- **Pretendimi i dytë (II)** - *“Tenderuesi i rekomanduar nuk ka port VGA siç është kërkuar në specifikat teknike minimale në dosjen e tenderit. Dëshmia për këtë kërkesë të dosjes së tenderit është katalogu i produkteve me weblink zyrtar për verifikim. Me datë 14.06.2023 në ora 15:23 publikohet vendimi mbi refuzimin e kërkesa për rishqyrtim ndërsa në të njëjtën kohë bëhet edhe pezullimi i aktivitetit të prokurimit. Me datë 14.06.2023 në ora 11:19 dmth rreth 18 orë pas kërkesës për rishqyrtim dhe rreth 4 orë para publikimit të vendimit për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ndodh ndryshimi i linkut në webfaqen e prodhuesit apo poseduesit të GoogleDrive (pra nuk është as weblink zyrtar për verifikim por është link që të dërgon në googledrive). Linku screenshot nga dokumentet e marra me USB kur kërkua qasjen e dokumenteve dhe kur bëme krahasimin e tyre me datë 12.06.2023 në këtë link nuk kishte VGA port ashtu siç edhe nuk ka nëdokumentet që janë pdf të cilat nuk mund të ndryshohen si dokumente të prezentuara me ofertë nga tenderuesi i rekomanduar. Screenshot nga linku mbi të cilin Autoriteti merr vendimin për refuzimin e kërkesës, del të jetështuar porti VGA. Mirëpo këtu kemi të bëjmë me modifikim me datë 14.06.2023 në ora 11:19 AM (pra 4 orë para vendimit vendimit mbi refuzimin e kërkesës sonë për këtë port VGA”.*
- **Pretendimi i tretë (III)** - *“Tenderuesi i rekomanduar nuk i ka të rregullta dokumentet siç janë autorizimi nga prodhuesi, granacioni nga prodhuesi dhe broshurat. Këto dokumente nuk përmbajnë informatat bazike siç është kontakti për verifikimin e autenticitetit të këtij autorizimit dhe kontakti për verifikimin e autenticitetit të validimit të garancionit. Pra duke marrë parasysh se oferta e tenderuesit të rekomanduar nuk ka plotësuar një numër të madh të kërkesave administrative dhe nuk ka plotësuar një kriter crucial të specifikimeve teknike siç është porti VGAX1, konkludojmë se kjo ofertë është dashur të refuzohet si e pa përgjegjshme për mos përmbushje të mundësive teknike dhe/ose profesionale dhe mos përmbushje të kushteve administrative”.*

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet 1, 7, 28, 53, 59, 60, 64 dhe 66 të LPP.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues në OSHP ka angazhuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues.

Duhet sqaruar se përmes nenit 114 paragrafit 1 të LPP përcaktohet se “*Eksperti shqyrtues, në afat prej dhjetë (10) ditësh, menjëherë pas emërimit të tij do të: (i) shqyrtojë dokumentacionin e prokurimit të autoritetit kontraktues dhe shënimet përkatëse, (ii) intervistojë, nëse ai e sheh të arsyeshme ose të nevojshme, cilindo zyrtar, nëpunës ose këshilltar të autoritetit kontraktues ose palës ankuese, dhe (iii) pajisë panelin shqyrtues, ankuesin dhe kryesuesin e autoritetit kontraktues me një vlerësim me shkrim mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të përfshira në ankesë*”.

Me datë 05.07.2023 është dorëzuar një raport i ekspertit shqyrtues i cili pas vlerësimit nga Paneli Shqyrtues ka rezultuar se nuk është hartuar në përputhje me nenin 114 paragrafin 1 lidhur me nenin 113 të LPP. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues është detyruar që të angazhoj edhe një ekspertizë të dytë (super-ekspertizë) me qëllim për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues.

Me datë 06.09.2023 është dorëzuar Raporti i Ekspertit Shqyrtues me rekomandimet si në vijim: “*ankesa të miratohet si pjesërisht e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim*”. Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritohor lidhur me rastin.

- *Administrimi dhe vlerësimi i provave* -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

**Lidhur me pretendimin e parë (I) ankimor,** eksperti shqyrtues në raportin e tij ka vlerësuar si në vijim “*lideri i konzorciumit NTG Blendi OP e ka plotësuar aneksin mirëpo partneri i konzorciumit Tech Vision Sh.P.K. nuk e ka plotësuar tabelën përkatëse të DT por ka dorëzuar një tabelë të plotësuar nga vet kompania. Sipas vlerësimit të ekspertit mos plotësimi i këtij aneksi nga partneri i konzorciumit nuk do të kishte impakt në vlerësimin përfundimtar të ofertës, prandaj pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar*”.

**Lidhur me pretendimin e dytë (II) ankimor,** eksperti shqyrtues në raportin e tij ka vlerësuar si në vijim “*bazuar në katalogun në ofertën e tenderuesit të rekomanduar shihet se mungon porti VGA, pra nuk është plotësuar kërkesa sipas dosjes së tenderit mirëpo linku i prezantuar sipas word dokumentit të shpie në faqen zyrtare të prodhuesit ku katalogu i prezantuar në këtë faqe nuk përkon me katalogun e prezentuar në ofertë dhe si rrjedhojë nuk mund të themi se kemi të bëjmë me verifikim të katalogut por me mospërputhje në të katalogut të ofruar dhe atij të prezantuar në webfaqe. Meqenëse kemi të bëjmë me pretendime ankimore të cilat kanë të bëjnë*

*me mundësi manipulative të weblinkut (editimit të dokumentit) të prezantuar në ofertë, rekomandohet që autoriteti kontraktues të kërkojë nga institucionet relevante që të dëshmojnë modifikimin ose jo të këtij dokumenti përmes KRPP apo institucionit tjetër relevant. Prandaj pretendimi është i bazuar”.*

**Lidhur me pretendimin e tretë (III) ankimor**, eksperti shqyrtues në raportin e tij ka vlerësuar si në vijim “*sa i përket pretendimit ankimor lidhur me mos dorëzimin e autorizimit nga prodhuesi MAF apo DAF për produktet e ofertuara mund të them se bazuar në dokumentacionin e paraqitur në ofertën e grupit të rekomanduar shihet se plotësohet dosja e tenderit konform kërkesave të cekura më parë. Prandaj pretendimi është i pabazuar”.*

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Për më tepër konstatimet e ekspertit shqyrtues janë të bazuara edhe në dispozitat përkatëse të LPP dhe RRPP. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet ankimore i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit shqyrtues. **Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i dytë (II) i operatorit ekonomik ankues është i bazuar ndërsa pretendimi i parë është pjesërisht i bazuar. Njëkohësisht është gjetur se pretendimi i tretë (III) është pretendim i pabazuar.**

*- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -*

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim nën 59 lidhur me nenet 27 dhe 28 të LPP.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të miratohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të anuluar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Komuna e Prishtinës të datës 06.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me tabela të mençura (smart) për institucionet arsimore në Komunë të Prishtinës” me numër të prokurimit 616-23-3949-1-1-1, ndërsa aktiviteti i prokurimit të kthehet në Rivlerësim sipas rekomandimit të superekspertizes.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veproj në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën OSHP mund të inicioj procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP. Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP. Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Vjosa Gradinaj**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - SolvIT SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: